

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS -
UNIVERSITETSKJE BOLNIČKE I KLINIČKE SLUŽBE KOSOVA -
THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO
ARKIVI QENDROR - CENTRALNI ARHIV - CENTRAL ARCHIVE

Nr. i njesis org. / Jed. / Org. unit:
Nr. i faq. / Br. str. / No. page: 4
Nr. Prot. / Broj. prot. / Prot. no.: 814
Data / Datum / Date: 22.03.22
PRISTINA - PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstvo / Ministry of Health
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut Javnog Zdravstva Kosova
National Institute of Public Health of Kosovo

Njesis org. / Org. Jed. / Org. Unit: 08
Nr. i faqave / Br. Stranaka / No. Page: 4
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 186
Data / Datum / Date: 22.03.2022
PRISTINA



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
Nacionalni Institut za Javno Zdravlje
National Institute of Public Health

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar Kosovës-SHSKUK
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova -UBKSK
Hospital and University Clinical Service of Kosovo-HUCSK

Në bazë të nenit 6, nenit 8, nenit 16 nenit 27 të Statutit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, nenit 13 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe nenit 13 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës duke u mbështetur në vullnetin e lirë të tyre, më 22.03.2022 në Prishtinë, Republika e Kosovës, lidhin këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

MBËSHTETETJEN DHE BASHKËPUNIMIN NË ZHVILLIMIN DHE AVANCIMIN E SHËRBIMEVE MIKROBIOLOGJIKE NDËRMJET SHËRBIMIT TË MIKROBIOLOGJISË KLINIKE NË QKUK DHE DEPARTAMENTIT TË MIKROBIOLOGJISË NË IKSHPK

Palët e marrëveshjes:

- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, me adresë: Rr: 'Nëna Terezë', pn 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Prof.Dr.Naser Ramadani këtu e tutje IKSHPK**
dhe
- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, me adresë: Lagjia e Spitalit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Dr.Valbon Krasniqi këtu e tutje SHSKUK**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është mbështetja e aktiviteteve të Shërbimit të Mikrobiologjisë Klinike në kuadër të QKUK-së deri në arritjen e kapaciteteve të plota të saj si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe i ndërsjelltë në zhvillimin profesional dhe shkencor të shërbimeve mikrobiologjike në IKSHPK dhe në SHSKUK.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Objekt i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit janë detyrimet e palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje për zbatimin e plotë të dispozitave që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Neni 3

Obligimet e IKSHPK

1. IKSHPK përmes Departamentit të Mikrobiologjisë kryen funksionin e laboratorit referent për konfirmimin e egzaminimeve të ndryshme mikrobiologjike në rast nevojë.
2. Në raste të pamundësisë teknike të kryerjes së egzaminimit mikrobiologjik në Shërbimin e mikrobiologjisë klinike në QKUK, IKSHPK do të mundësojë kryerjen e këtyre egzaminimeve laboratorike brenda kapaciteteve në dispozicion.
3. IKSHPK do të mbështesë profesionalisht Shërbimin e Mikrobiologjisë klinike në QKUK deri në ngritjen e plotë të kapaciteteve dhe funksionimit të vazhdueshëm.
4. IKSHPK brenda kapaciteteve në dispozicion, do të mbështesë Shërbimin e Mikrobiologjisë Klinike në QKUK me materiale shpenzuese në rast të mungesave eventuale me qëllim mosndërprerjen e punës deri në stabilizim të furnizimit.

Neni 4

Obligimet e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – SHSKUK

1. SHSKUK merr përsipër, që në rast nevojë, të mbështesë Departamentin e Mikrobiologjisë në kuadër të IKSHPK me të gjitha kapacitetet njerëzore dhe teknike.
2. SHSKUK, kohë pas kohe, do të dërgojë mostra për konfirmim në Departamentin e Mikrobiologjisë në IKSHPK si laborator referent.
3. SHSKUK përmes Shërbimit të Mikrobiologjisë Klinike në QKUK do të bashkëpunojë me Departamentin e Mikrobiologjisë në IKSHPK për mbikqyrjen e rezistencës antimikrobike dhe infeksioneve të ndërlidhura me kujdesin shëndetësor si dhe çeshtje tjera nga diagnostika laboratorike e sëmundjeve ngjitëse.

4. SHSKUK përmes Shërbimit të Mikrobiologjisë Klinike në QKUK do të mbështesë Departamentin e Mikrobiologjisë në IKSHPK me materiale shpenzuese në rast të mungesave eventuale.

Neni 5

Obligimet e përbashkëta të palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshje të bashkëpunimit

1. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje bashkëpunimi pajtohen që të shkëmbejnë përvojat dhe të arriturat me qëllim të ngritjes profesionale dhe shkencore të stafit.
2. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje bashkëpunimi pajtohen që do të mbështesin njëra-tjetrën me ekspertizë, staf dhe material shpenzues me qëllim të ofrimit sa më efikas të shërbimeve mikrobiologjike.
3. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje bashkëpunimi, po ashtu pajtohen që do të bashkëpunojnë në aspektin shkencor dhe në edukim të vazhdueshëm profesional.

Neni 6

Personat përgjegjës për zbatim të marrëveshjes

1. Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje bashkëpunimi, pajtohen që të caktojnë personat përgjegjës të autorizuar për komunikim ndërmjet tyre lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshje, si vijon:
 - 1.1. Për IKSHPK Dr.Xhevat Jakupi Drejtor i Departamentit të Mikrobiologjisë në IKSHPK;
 - 1.2. Për SHSKUK Dr.Greta Lila Drejtor i Shërbimit të Mikrobiologjisë Klinike në QKUK.

Neni 7

Mosmarrëveshjet

1. Për çdo kontest apo mosmarrëveshje lidhur me dispozitat e kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, palët nënshkruese të saj, do të bëjnë shkëputjen e kësaj marrëveshje në formë të dyanshme dhe miqësore.
2. Në rast të krijimit të rrethanave të reja, palët me dakordim të dyanshëm mund të lidhin aneks-marrëveshje për rregullimin e tyre.
3. Shkëputja e kësaj marrëveshje bashkëpunimi, mund të bëhet me njoftim paraprak prej 45 ditësh nga pala përkatëse.

Neni 8

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është e hartuar në katër (4) kopje origjinale, nga dy (2) për secilën palë nënshkruese.

Neni 9
Afati kohor dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi më 22/03/2022 dhe zgjat për katër (4) vite deri më 21/03/2026

Palët nënshkruese:

Prof.Dr.Naser Ramadan

Drejtör Ekzekutiv, IKSHPK



Dr.Valbon Krasniqi

Drejtör i Përgjithshëm i SHSKUK-se



Mars, 2022